

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KORPORATWN ELEKTROENERGJETIKE

SHQIPTARE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Operatorin e Sistemit të Transmetimit, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën 01.07.2012 - 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 80 datë 30.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 1189/6 datë 26.02.2013, dërguar Z. Wngjwll Zeqo, Administrator i OST, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës, të analizojnë dhe të marrin masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH për 1 masë organizative në proces, 2 masat organizative të pa realizuara si dhe për 2 masa shpërblim dëmi në proces.

Të kryhet ndalesa e vlerës prej 2,293,584 lekë ndaj shoqërisë “████” sh.p.k. si edhe ndalesa e vlerës prej 438,084 lekë, shoqërisë “████” sh.p.k. me përfundimin e kontratës së punimeve.

Deri më datë 30.08.2014

2. Këshilli Mbikëqyrës, të marrë masat për të hartuar programin vjetor të veprimtarisë së tij bazuar në pikën III “Procedurat për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit mbikëqyrës”, 1 e 2 të Udhëzimit nr. 318, datë 08.04.2009, të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”.

Në vazhdimësi

3. Këshilli Mbikëqyrës, të miratojë dhe shqyrtojë në afat pasqyrat financiare, në përputhje me afatet e përcaktuara në Udhëzimin e METE, nr. 318 datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, paragrafi IV, pika 7.

Në vazhdimësi

4. Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë së OST, të marrin masa për miratimin rregullores së brendshme, në të cilën të implementohen rregulla në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Deri më datë 30.08.2014

5. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të marrin masat e nevojshme për të përcaktuar dhe zbatuar procedura të rregullta, për shpenzimet e kryera për udhëtim e dieta brenda vendit, duke i plotësuar me dokumentacionin justifikues sipas kërkesave ligjore.

Në vazhdimësi

6. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e procedurave të prokurimit publik për blerje me vlera të vogla, në kryerjen e procedurave të shpenzimeve për blerje bileta udhëtimi jashtë vendit, si dhe likuidimi i shpenzimeve të bëhet referuar legjislacionit në fuqi.

Në vazhdimësi

7. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të marrin masat e nevojshme për miradministrimin e shpenzimeve për karburant, duke përcaktuar dhe plotësuar fletë shërbimet që pasqyrojnë kilometrat e përshkruara prej tyre, cilësimin e destinacionit dhe distancave.

Në vazhdimësi

8. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të marrin masat e nevojshme dhe të bashkërendojnë punën me njësitë vartëse, për të programuar saktë nevojat për prokurimet me vlera të vogla për punë, mallra dhe shërbime, të përcaktojnë grup mallra e shërbime sipas natyrës së përdorimit, për të shmangur copëzimin e fondeve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit me efektivitet, transparencë dhe konkurrencë të operatorëve ekonomikë.

Në vazhdimësi

9. Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë, të marrin masa që për nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të zbatojnë kërkesat e ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, si dhe kërkesat e Kodit të Punës, duke i harmonizuar ato me kontratën kolektive të punës dhe aktet e tjera ligjore për funksionimin e shoqërisë.

Në vazhdimësi

10. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë për penalizmin e OST Sha, si rezultat i vendimeve të gjykatave për largime nga puna pa shkaqe të arsyeshme, pasi OST Sha për periudhën korrik 2012 - 2013 është penalizuar në 7 raste në shumën 7,958,760 lekë.

Deri më datë 30.08.2014

11. Administratori dhe departamentet përkatëse, të marrin masa për evadimin e materialeve stoqe në magazinë dhe për nxjerrjen nga përdorimi, vlera e të cilave është 20,310 mijë lekë.

Deri më datë 30.08.2014

12. Administratori shoqërisë dhe Drejtoria Ekonomike, të marrin masa për përfundimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të shoqërisë të vitit 2013.

Deri më datë 30.08.2014

13. Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i shoqërisë dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë, të marrin masat e nevojshme administrative deri edhe gjyqësore për të arkëtuar shumën e detyrimit të CEZ shpërndarje Sha prej 12,053,471 mijë lekë, rezultuar në fund të vitit 2013, të cilat dëmtojnë ecurinë e OST Sha.

Deri më datë 30.09.2014

14. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të marrin masat e nevojshme për të bërë ndjekjen sistematike dhe të vazhdueshme të arkëtimeve dhe mbajtjen e kërkesave të arkëtueshme të klasifikuara sipas afateve të maturimit të tyre.

Në vazhdimësi

15. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të marrin masa për shlyerjen e detyrimeve ndaj furnitorëve dhe kreditorëve si edhe shlyerjen e detyrimeve kreditore ndaj KESH Sh.A në vlerën 232,154 lekë.

Deri më datë 30.08.2014

16. Departamenti i Auditit të Brendshëm, të përfundojë hartimin e manualit specifik dhe kartës së auditit të brendshëm të “OST Sha”, në përputhje me Manualin e Auditit të Brendshëm, në të cilin përcaktohet se “të gjitha njësitë e AB janë të detyruara të hartojnë dhe miratojnë metodikën e veçantë të AB-së, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e MAB”.

Deri më datë 30.08.2014

17. Departamenti i Auditit të Brendshëm të plotësojë formatin e riskut, si pjesë e programit të angazhimit të auditimit.

Deri më datë 30.08.2014

18. Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i shoqërisë dhe Departamenti i Auditit të Brendshëm, të marrin masa për të zbatuar Urdhrin e Kryeministrit nr. 70, datë 18.04.2006, “Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit a të ministrave” si dhe Udhëzimin nr. 12, datë 05.06.2012, i Ministrit të Financave, “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Në vazhdimësi

19. Departamenti i Auditit të Brendshëm, të marrë masat e nevojshme që rekomandimet e dhëna të plotësojnë kërkesat e ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 21 “Përgjegjësitë e audituesve të brendshëm”, pika 7, pasi një numër i konsiderueshëm i tyre, janë larg këtyre kërkesave.

Në vazhdimësi

20. Administratori i shoqërisë, drejtori i NJOE dhe departamentet përkatëse, të marrin masa të menjëhershme për administrimin, magazinimin dhe sigurinë e aseteve të demontuara dhe materialeve të reja në magazinën e marrë me qira, për të siguruar kushtet e ruajtjes dhe mbrojtjes fizike të tyre sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Deri më datë 30.08.2014

21. Administratori, drejtori i NJOE dhe departamentet përkatëse të marrin masa për të përfunduar inventarizimin e aseteve të kësaj njësie për vitin 2013, sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 20.07.2011 dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e

sektorit publik” Kreu IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, “Inventarizimi i aktiveve” të Ministrisë së Financave.

Deri mëdatë 30.08.2014

22. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të analizojnë dhe të marrin masa për të shmangur mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit dhe zbatimin e kontratave në lidhje me:

- ndryshimin e kushteve kontraktore, pas shpalljes së ofertës fituese;
- përdorimin e referencave të markës në specifikimet teknike;
- çlirimin e garancisë së kontraktorit pa plotësuar detyrimin kontraktor;
- plotësimin e të gjitha kërkesave të DST, kryesisht në rastin e bashkimit të operatorëve;
- amendimin e kontratave për furnizim me mallra për shtesë afati, duke shmangur penalizmin e kontraktorit për vonesa në realizimin e tyre;
- përcaktimin me saktësi të fondit limit, duke marrë të dhëna edhe nga organet tatimore e doganore, si dhe të detajuar nga specialistë të fushave;
- prokurimin e blerjeve me vlera të vogla për mallra të së njëjtës natyrë dhe pa tejkaluar limitin e tyre vjetor.

Vazhdimisht

23. OST, të marrë masa për rialokimin e fondeve nga CEZ-Shpërndarje, për investimin e realizuar në linjën 35 kV N/Stacioni Sharre - Shtylla Degëzuese e L30-30/2-1, me vlerë 6,099 mijë lekë pa t.v.sh.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Administratori, drejtorët e Njësive Operative dhe departamentet përkatëse, të marrin masat e nevojshme për arkëtimin e shumës prej **5,318,250 lekë**, për kuotën ushqimore/ditore, përfituar padrejtësisht nga punonjësit e aparatit për ditët që kanë shkuar me shërbim brenda vendit si edhe për ditët e lejes vjetore, në kundërshtim me nenin 63 të kontratës kolektive.

2. Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të marrin masat e nevojshme për arkëtimin e shumës prej **2.283.500 lekë**, për kuotën ushqimore/ditore, përfituar padrejtësisht nga punonjësit e aparatit për ditët që kanë shkuar me shërbim brenda dhe jashtë vendit si edhe për ditët e lejes vjetore.

3. Administratori, drejtori i NJOE dhe departamentet përkatëse të marrin masa për arkëtimin e shumës **185,155 lekë**, të përfituar padrejtësisht nga punonjësit për orët jashtë orarit të punës në kundërshtim me nenin 31 të kontratës kolektive të punës:

Njësia Operative Elbasan	227,000 lekë
Njësia Operative Tiranë	571,500 lekë
Njësia Operative Fier	954,000 lekë
Njësia Operative Korçë	392,750 lekë
Njësia Operative Burrel	17,500 lekë
Njësia Operative Shkodër	1,292,000 lekë
Njësia Mirëmbajtjes dhe Transmetimit	1,863,500 lekë.

4. Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës **1,353,600 lekë**, llogaritur si penalitet i pambajtur

ndaj subjektit “████” sh.p.k, në zbatimin e kontratës “Blerje automjet 7 ton” realizuar nga Njësia OST Tiranë nr. 1.

5. OST të marrë masa për të kryer ndalesën e garancisë së punimeve për Kontraktorin “████” sh.p.k me vlerë **1,101,545 lekë**, pasi nuk ka realizuar punimet e kontratës “Rikonstruksion i linjës 110 kw Tirana 1-Kashar, konform projektit dhe specifikimeve teknike. Gjithashtu, pas realizimit të vlerësimit të zbatimit të punimeve, të bëhen llogaritjet dhe të zbritet vlëra, sipas rezultateve të vlerësimit, për pajisje të vendosura në kundërshtim me specifikimet teknike të kontratës.

6. Administratori i shoqërisë, të marrë masat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për të arkëtuar shumën **243,420 lekë**, për punonjësit të cilët në zbatimin e kontratave të shërbimit me operatorët e telefonisë celulare, rezultojnë me detyrime ndaj shoqërisë, shumë e cila përbën dëm ekonomik.

7. Administratori i shoqërisë, të marrë masat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e shumës **119.000 lekë**, përfituar padrejtësisht nga punonjësit e OST, për vitet 2012 - 2013 për udhëtim e dieta në ditët e shtuna e të diela, ose jashtë kohës normale të punës në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, e cila përbën dëm ekonomik.

8. Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës **385,509 lekë**, përfituar padrejtësisht nga subjekti “████” sh.p.k, në zbatimin e kontratës “Ndërtim sheshe depozitimi me bazamente betoni dhe të mbuluar, ne N/Stacionet Elbasan 1, Fier dhe Koms (Burrel)”, si më poshtë:

-69,000 lekë, për pagesa në kundërshtim me kontratën.

-315,509 lekë, llogaritur penaltet për mos përfundim të punimeve sipas afatit të përcaktuar në kontratë.

C. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në prokurimet publike për periudhën 01.07.2012 deri më 31.12.2013, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në raportin përfundimtar të auditimit, bazuar në nenet 13 (pika “i”) dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 3, kreut X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, **i kërkojmë Agjencisë së Prokurimit Publik** të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke rekomanduar marrjen e masave administrative për punonjësit si më poshtë:

1. Z. █████ në cilësinë e anëtarit të KVO, sepse:

-në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje aparate dhe pajisje për kontrollin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve primare të nënstacioneve”, ka pranuar oferta nga operatorët ekonomikë, dokumentacioni i të cilave nuk është përkthyer në gjuhën e ofertës, në kundërshtim me dokumentet e tenderit.

- në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje dhe implementimi i një platforme elektronike për realizimin e një sistemi të integruar të administrimit të burimeve financiare, njerëzore dhe logjistike të OST sh.a.”, ka marrë në konsideratë dokumentacionin nga operatorët ekonomikë, pas afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me VKM nr. 659, datë 03.10.2007 “Për rregullat e kryerjes së procedurave të prokurimit publik me mjete elektronike”, udhëzimeve të APP “Për operatorët ekonomik”, kreu I, pikat 5, 6, kreu III pika 12 dhe Dokumenteve Standarde të Tenderit kreu 3 Udhëzime për operatorët ekonomik, pika 3.11.

Autorizimi për pajisje për një operator ofertues është pranuar edhe pse nuk është përkthyer në gjuhën e ofertës, si dhe janë pranuar ofertat e dy operatorëve ekonomikë, megjithëse kanë paraqitur autorizim prodhuesi të njëjtë, në kundërshtim me dokumentet e tenderit.

2. Z [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të KVO, sepse:

- në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje aparate dhe pajisje për kontrollin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve primare te nënstacioneve”, ka pranuar oferta nga operatorët ekonomikë, dokumentacioni i të cilave nuk është përkthyer në gjuhën e ofertës, në kundërshtim me dokumentet e tenderit.

- në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje Karburant për vitin 2013”, ka kualifikuar një operator ekonomik edhe pse në tender nuk ka paraqitur dokumentacionin sipas kërkesës së autoritetit kontraktor të përcaktuar në pikën 2.1.1, të kërkesave të veçanta të kualifikimit, e cila ka të bëjë me lejen me kod III. 1. B në fushën “Mjedis dhe burime mjedisore bazë” Kategoria: “Për ndikimin në mjedis”, Nën Kategoria: “Leje mjedisore”.

Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentin “Autorizim” për tregtim të karburanteve dhe gaz për kategorinë e produkteve të llojit “A” dhe “B” i cili nuk ishte lëshuar për operatorin ekonomik ofertues, por për një operator tjetër.

Pas realizimit të procedurës së negocimit, pasi tenderi është anuluar dy herë për mungesë pjesëmarrje, është rënë dakord të furnizohet karburant duke përcaktuar marzhin e fitimit 18.5 lekë/litër, ndërkohë që çmimi më i favorshëm i paraqitur në dy procedurat e anuluar është 17 lekë/litër, duke rritur në këtë mënyrë shpenzimet e autoritetit kontraktor me vlerë 67, 500 lekë.

- në procedurën “Blerje automjet me kosh për punimet në lartësi”, është kualifikuar një operator ekonomik me të cilin është nënshkruar kontrata edhe pse nuk ka përmbushur kriterin e punimeve të ngjashme që duhet të ishin realizuar nga operatori ekonomik, për periudhën e kërkuar në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me dokumentet e tenderit Shtojca 7, Pika 2 “Kritere të veçanta të kualifikimit” Pika. 3 “Kapaciteti teknik”.

- ka tejkaluar limitin ligjor prej 400 mijë lekë/vit për të 2 procedurat e prokurimit të parashikuara dhe realizuara “Sigurim i autotransformatorëve”, “Rimbushje e fikseve të zjarrit”, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 26.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2/a dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VI pika 2/ a “Prokurimi me vlerë të vogël”.

3. Z [REDAKTUAR] cilësinë e anëtarit të KVO, sepse:

- në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje Karburant për vitin 2013”, ka kualifikuar një operator ekonomik edhe pse në tender nuk ka paraqitur dokumentacionin sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, të përcaktuar në pikën 2.1.1, të kërkesave të veçanta të kualifikimit, e cila ka të bëjë me lejen me kod III. 1. B ne fushën “Mjedis dhe burime mjedisore bazë” Kategoria: “Për ndikimin në mjedis”, Nën Kategoria: “Leje mjedisore” .

Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentin “Autorizim”, për tregtim të karburanteve dhe gaz për kategorinë e produkteve të llojit “A” dhe “B” i cili nuk ishte lëshuar për operatorin ekonomik ofertues, por për një operator tjetër.

Pas realizimit të procedurës së negocimit, pasi tenderi është anuluar dy herë për mungesë pjesëmarrje, është rënë dakord të furnizohet karburant duke përcaktuar marzhin e fitimit 18.5 lekë për litër, ndërkohë që çmimi më i favorshëm i paraqitur në dy procedurat e anuluar është 17 lekë për litër, duke rritur në këtë mënyrë shpenzimet e autoritetit kontraktor me vlerë 67, 500 lekë.

- në procedurën “Blerje automjet me kosh për punimet në lartësi”, është kualifikuar një operator ekonomik me të cilin është nënshkruar kontrata edhe pse nuk ka përmbushur kriterin e punimeve të ngjashme që duhet të ishin realizuar nga operatori ekonomik, për periudhën e kërkuar në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me dokumentet e tenderit Shtojca 7, Pika 2 “Kritere të veçanta të kualifikimit” Pika. 3 “Kapaciteti teknik”.

4. Z. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të KVO, sepse:

- në procedurën “Blerje automjet me kosh për punimet në lartësi”, është kualifikuar një operator ekonomik me të cilin është nënshkruar kontrata edhe pse nuk ka përmbushur kriterin e punimeve të ngjashme që duhet të ishin realizuar nga operatori ekonomik, për periudhën e kërkuar në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me dokumentet e tenderit Shtojca 7, Pika 2 “Kritere të veçanta të kualifikimit” Pika. 3 “Kapaciteti teknik”.

- në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje Karburant për vitin 2013”, ka kualifikuar një operator ekonomik edhe pse në tender nuk ka paraqitur dokumentacionin sipas kërkesës së autoritetit kontraktor të përcaktuar në pikën 2.1.1, të kërkesave të veçanta të kualifikimit, e cila ka të bëjë me lejen me kod III. 1. B në fushën “Mjedis dhe burime mjedisore bazë” Kategoria: “Për ndikimin në mjedis”, Nën Kategoria: “Leje mjedisore”.

Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentin “Autorizim” për tregtim të karburanteve dhe gaz për kategorinë e produkteve të llojit “A” dhe “B” i cili nuk ishte lëshuar për operatorin ekonomik ofertues, por për një operator tjetër.

Pas realizimit të procedurës së negocimit, pasi tenderi është anuluar dy herë për mungesë pjesëmarrje, është rënë dakord të furnizohet karburant duke përcaktuar marzhin e fitimit 18.5 lekë për litër, ndërkohë që çmimi më i favorshëm i paraqitur në dy procedurat e anuluar është 17 lekë/litër, duke rritur në këtë mënyrë shpenzimet e autoritetit kontraktor me vlerë 67, 500 lekë.

5. Z. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të KVO, sepse:

- në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje Karburant për vitin 2013”, ka kualifikuar një operator ekonomik edhe pse në tender nuk ka paraqitur dokumentacionin sipas kërkesës së autoritetit kontraktor të përcaktuar në pikën 2.1.1, të kërkesave të veçanta të kualifikimit, e cila ka të bëjë me lejen me kod III. 1. B në fushën “Mjedis dhe burime mjedisore bazë” Kategoria: “Për ndikimin në mjedis”, Nën Kategoria: “Leje mjedisore”.

Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentin “Autorizim” për tregtim të karburanteve dhe gaz për kategorinë e produkteve të llojit “A” dhe “B” i cili nuk ishte lëshuar për operatorin ekonomik ofertues, por për një operator tjetër.

Pas realizimit të procedurës së negocimit, pasi tenderi është anuluar dy herë për mungesë pjesëmarrje, është rënë dakord të furnizohet karburant duke përcaktuar marzhin e fitimit 18.5 lekë për litër, ndërkohë që çmimi më i favorshëm i paraqitur në dy procedurat e anuluar është 17 lekë për litër, duke rritur në këtë mënyrë shpenzimet e autoritetit kontraktor me vlerë 67, 500 lekë.

6. Z. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të KVO, sepse:

- në procedurën “Blerje automjet me kosh për punimet në lartësi”, është kualifikuar një operator ekonomik me të cilin është nënshkruar kontrata edhe pse nuk ka përmbushur kriterin e punimeve të ngjashme që duhet të ishin realizuar nga operatori ekonomik për periudhën e kërkuar në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me dokumentet e tenderit Shtojca 7, Pika 2 “Kritere të veçanta të kualifikimit” Pika. 3 “Kapaciteti teknik”.

7. Z. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarëve të KVO, sepse:

- në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje aparate dhe pajisje për kontrollin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve primare te nënstacioneve”, ka pranuar oferta nga operatorët ekonomikë, dokumentacioni i të cilave nuk është përkthyer në gjuhën e ofertës, në kundërshtim me dokumentet e tenderit.

8. Znj. [REDAKTUAR]

9. Z. [REDAKTUAR]

10. Z. [REDAKTUAR]

11. Znj. [REDAKTUAR]

12. Z. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarëve të KVO, sepse:

- në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje dhe implementimi i një platforme elektronike për realizimin e një sistemi të integruar të administrimit të burimeve financiare, njerëzore dhe logjistike të OST sh.a.”, kanë marrë në konsideratë dokumentacionin nga operatorët ekonomikë, pas afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me VKM nr. 659, datë 03.10.2007 “Për rregullat e kryerjes së procedurave të prokurimit publik me mjete elektronike”, udhëzimeve të APP “Për operatorët ekonomik”, kreu I, pikat 5, 6, kreu III pika 12 dhe Dokumenteve Standarde të Tenderit kreu 3 Udhëzime për operatorët ekonomik, pika 3.11.

Autorizimi për pajisje për një operator ofertues është pranuar edhe pse nuk është përkthyer në gjuhën e ofertës, si dhe janë pranuar ofertat e dy operatorëve ekonomikë, megjithëse kana paraqitur autorizim prodhuesi të njëjtë, në kundërshtim me dokumentet e tenderit.

Zj. [REDAKTUAR] ka lejuar blerjen dhe ka realizuar pagesa për biletat udhëtimi jashtë vendit në shumën **6,300,331 lekë**, pa u kryer asnjë procedurë prokurimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.

13. Z. [REDAKTUAR]

14. Z. [REDAKTUAR]

15. Z. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla, NJOB sepse:

- nuk kanë kryer llogaritjen e vlerës në procedurën me objekt “sigurimi i autotrasformatorëve” si dhe mos përcaktimi i llojit të sigurimit, etj, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 Kreu VI pika 2/b “Prokurimi me vlerë të vogël” ku citohet se: “kur lind nevoja për punë mallra dhe shërbime, autoriteti kontraktor lëshon një urdhër ku përcaktohet natyra dhe sasia e tyre”.

- në ftesën për ofertë datë 18.09.2013 nuk kanë të përcaktuar vlerën e 2 copë autotransformatorëve mbi të cilën llogaritet edhe vlera e sigurimit, pa përcaktuar llojin e sigurimit, pra sigurim nga zjarri, nga përmytjet, etj, në këto kushte procedura e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 1 “Objekti dhe Qëllimi” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

16. Z. [REDAKTUAR]

17. Z. [REDAKTUAR]

18. Znj. [REDAKTUAR]

19. Z. [REDAKTUAR]

20. Z. [REDAKTUAR]

21. Z. [REDAKTUAR] anëtarë në komisionit e blerjeve me vlera të vogla NJOSH, sepse:

-nuk ka kryer llogaritjen e vlerës në procedurën me objekt “sigurimi i autotrasformatorëve” si dhe mos përcaktimin e llojit të sigurimit, etj, veprim në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 Kreu VI pika 2/b “Prokurimi me vlerë të vogël”.

-për shkak se në ftesën për ofertë datë 18.09.2013 ku nuk kanë të përcaktuar vlerën e 7 copë autotransformatorëve mbi të cilën llogaritet edhe vlera e sigurimit, pa përcaktuar llojin e sigurimit, pra sigurim nga zjarri, nga përmbytjet, etj, në këto kushte procedura e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 1 “Objekti dhe Qëllimi” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

22. Znj. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtares së komisionit të blerjeve me vlera të vogla NJOE, sepse:

- në prokurimet me vlera të vogla, nuk përcaktohet lloji dhe natyra e mallrave, etj, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 Kreu VI pika2/b “Prokurimi me vlerë të vogël” ku citohet se kur lind nevoja për punë mallra dhe shërbime, autoriteti kontraktor lëshon një urdhër ku përcaktohet natyra dhe sasia e tyre.

23. Z. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-shefit të NJOE, sepse:

- ka kryer copëzimin e fondeve për prokurime, ka zhvilluar procedura prokurimi me blerje me vlera të vogla, për të cilat duhej të zhvilloheshin 7 procedura tenderimi, duke tejkaluar limitin ligjor prej 480 mijë lekë/vit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 26.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2/a dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VI pika 2/ a “Prokurimi me vlerë të vogël”.

24. Z. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlera të vogla, sepse:

- për të gjitha prokurimet me vlera të vogla, nuk përcaktohet lloji dhe natyra e mallrave, etj, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 Kreu VI pika2/b “Prokurimi me vlerë të vogël” ku citohet se kur lind nevoja për punë mallra dhe shërbime, autoriteti kontraktor lëshon një urdhër ku përcaktohet natyra dhe sasia e tyre.

25. Z. [REDAKTUAR]

26. Z. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarëve të komisionit të prokurimeve me vlera të vogla, sepse:

- ftesa për ofertë drejtuar kompanive të sigurimit “[REDAKTUAR]”, “[REDAKTUAR]” dhe “[REDAKTUAR]” më datë 16.05.2013 nuk ka të përcaktuar vlerën e 5 copë autotransformatorëve mbi të cilën llogaritet edhe vlera e sigurimit, por kërkohet sigurimi për 5 autotransformatorë pa përcaktuar llojin e sigurimit, pra sigurim nga zjarri, nga përmbytjet, etj, në këto kushte procedura e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 1 “Objekti dhe Qëllimi” dhe VKM nr. nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi komisionin e blerjeve me vlera të vogla

27. Znj. [REDAKTUAR]

28. Z. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarëve të komisionit të prokurimeve me vlera të vogla, sepse:

- ftesa për ofertë drejtuar kompanive të sigurimit “[REDAKTUAR]”, “[REDAKTUAR]” dhe “[REDAKTUAR]” më datë 16.05.2013 nuk ka të përcaktuar vlerën e 5 copë autotransformatorëve mbi të cilën llogaritet edhe vlera e sigurimit, por kërkohet sigurimi për 5 autotransformatorë pa përcaktuar llojin e sigurimit, pra sigurim nga zjarri, nga përmbytjet, etj, në këto kushte procedura e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 1 “Objekti dhe Qëllimi” dhe VKM nr. nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi komisionin e blerjeve me vlera të vogla

- në të gjitha prokurimet me vlera të vogla, nuk ka përcaktuar llojin dhe natyrën e mallrave, etj, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 Kreu VI pika2/b “Prokurimi me vlerë të vogël” ku citohet se kur lind nevoja për punë mallra dhe shërbime, autoriteti kontraktor lëshon një urdhër ku përcaktohet natyra dhe sasia e tyre.

D. MASA DISIPLINORE

Bazuar në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 37, si dhe Kontratën kolektive të punës nr. 2298/7, datë 20.06.2013 të nënshkruar midis OST Sha dhe Sindikatës së Pavarur dhe punonjësve të Shoqërisë, neni 67 **kërkojmë nga Administratori i OST Sha të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:**

I “Pushim nga Puna” për:

1. Znj. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike, sepse:

- për rikonstrukcionin e linjës 35 kv N/Stacioni Sharre-Shtylla Degëzuese e L30-30/2-1”, është realizuar një investim me vlerë 6,099, mijë lekë në një linjë e cila është në administrim të CEZ-Shpërndarje. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, rezulton se nga OST nuk janë marrë masat për kërkimin e alokimit të fondeve për investimin e realizuar në vlerën 6,099 mijë lekë pa t.v.sh.

-në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje dhe implementimi i një platforme elektronike për realizimin e një sistemi të integruar të administrimit të burimeve financiare, njerëzore dhe logjistike të OST sh.a.”, ka marrë në konsideratë dokumentacionin nga operatorët ekonomikë, pas afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me VKM nr. 659, datë 03.10.2007 “Për rregullat e kryerjes së procedurave të prokurimit publik me mjete elektronike”, udhëzimeve të APP “Për operatorët ekonomik”, kreu I, pikat 5, 6, kreu III, pika 12 dhe Dokumenteve Standarde të Tenderit kreu 3, Udhëzime për operatorët ekonomik, pika 3.11.

- ka pranuar autorizimin për pajisje për një operator ofertues edhe pse nuk është përkthyer në gjuhën e ofertës, si dhe janë pranuar ofertat e dy operatorëve ekonomikë, megjithëse kanë paraqitur autorizim prodhuesi të njëjtë, në kundërshtim me dokumentet e tenderit.

- ka lejuar blerjen dhe pagesat për biletat e udhëtimit jashtë vendit në shumën **6,300,331 lekë**, pa kryer asnjë procedurë prokurimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.

- nuk ka ndërmarrë hapa për implementimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, në rregulloren e funksionimit të shoqërisë.

- ka kryer me vonesë pagesat e detyrimeve tatimore, pagesa me vonesë e faturave telefonik ndaj [REDAKTUAR] dhe duke mos zbatuar vullnetarisht urdhrat ekzekutiv ka sjell penalizmin e shoqërisë me gjoba, kamatëvonesa, pagesa interesi dhe pagesa ndaj përmbauesit privat në shumën 2,995,159 lekë, vlerë e cila rëndon situatën financiare të shoqërisë.

- ka kryer parapagesën e faturës telefonike ndaj kompanisë [REDAKTUAR] për gjithë detyrimet e punonjësve dhe mos arkëtimit të plotë të këtyre shumave prej punonjësve që janë larguar nga puna, veprim i cili ka sjellë debitorë në rritje. Shuma e debisë e pa likuiduar nga punonjësit është me vlerë **243,420 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë.

- ka kryer pagesa të padrejta për shpenzime udhëtime e dieta për ditët e shtuna e të diela, për të cilat në asnjë rast nuk ka informacion ose përshkrim të qëllimit të shërbimit për raste emergjence, duke shkaktuar dëm në shumën **119,000 lekë**, e cila është përfituar padrejtësisht nga punonjësit.

Këto pagesa janë kryer në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 31, datë 05.10.2007 si dhe me VKM nr. 997, datë 10.12.2010

- ka kryer pagesa të padrejta për kuotën ushqimore të përfituar nga punonjësit e aparatit për kuotën ushqimore ditore prej 500 lekë, në vlerën **2,283,500 lekë**, për ditët që punonjësit kanë shkuar me shërbim brenda dhe jashtë vendit, si dhe ditëve që kanë qenë me leje vjetore, në kundërshtim me nenin 63 të kontratave kolektive të punës nr. 988/2, datë 01.06.2010 dhe nr. 2298/7, datë 20.06.2013.

2. Z. ■■■ me detyrë specialist në Drejtorinë Ekonomike dhe Financës, sepse:

- ka kryer me vonesë likuidimin e detyrimeve tatimore, të faturave telefonike ndaj Albtelekom, duke sjellë penalizmin e shoqërisë me gjoba, kamatëvonesa dhe pagesa interesi në shumën 2,995,159 lekë, vlerë e cila ka rënduar situatën financiare të shoqërisë.

- ka kryer blerjen e biletave të udhëtimit jashtë vendit në shumën **6,300,331 lekë** pa kryer asnjë procedurë prokurimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.

- ka kryer pagesën e faturës telefonike ndaj kompanisë ■■■ për gjithë detyrimet e punonjësve dhe mos arkëtimin e plotë të këtyre shumave prej punonjësve që janë larguar nga puna. Veprim i cili ka sjellë debitorë në rritje, shuma totale e debisë e pa likuiduar nga punonjësit është **243,420 lekë**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë.

3. Zj. ■■■ me detyrë specialiste e Burimeve Njerëzore, sepse:

- ka kryer detyrën për ndjekjen e shpenzimeve telefonike me kompaninë celulare ■■■ pa autorizim nga Administratori si edhe pa u përcaktuar në përkrahimin e detyrave në rregulloren e Brendshme të Funksionimit të Shoqërisë dhe në kontratën Kolektive të punës, e cila ka sjell pasojë dëm ekonomik,

- për mos evidentimin dhe mos kryerjen në kohë të arkëtimit të detyrimeve të punonjësve për shpenzimet e telefonisë celulare në shumën **243,420 lekë**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë, veprime të cilat kanë sjellë debitorë në rritje, vështirësi dhe kosto për ndjekjen e tyre.

4. Z. ■■■ në cilësinë e menaxherit të kontratës, sepse:

- gjatë zbatimit të kontratës “Blerje dhe implementimi i një platforme elektronike për realizimin e një sistemi të integruar të administrimit të burimeve financiare, njerëzore dhe logjistike të OST sh.a.” rezulton se, furnizimi i disa pajisjeve dhe shërbimeve është bërë përtej afatit të përcaktuar në kontratë. Për këtë arsye Kontraktori duhet të penalizohet me vlerë **3,412,300 lekë**.

II. “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për:

1. Znj. ■■■ në cilësinë e menaxheres së kontratave, sepse:

- në zbatimin e kontratës së punimeve civile “Ndërtim sheshe depozitimi me bazamente betoni dhe te mbuluar në N/Stacionet Elbasan 1, Fier dhe Komsj (Burrel)” ka autorizuar përdorimin e fondit rezervë pas përfundimit të kontratës, në kundërshtim me Udhëzimin e KM Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Pika 19. Po ashtu, pas përfundimit të punimeve të kontratës janë likuiduar 60 orë pune me makineri, duke shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 69,120 lekë.

Referuar datës së fillimit të punimeve dhe datës së njoftimit të përfundimit të tyre, ka rezultuar se punimet civile kanë përfunduar me 16 ditë vonesë. Bazuar në Nenin 22, të kontratës, për dorëzim të vonuar, kontraktori duhet të penalizohet me vlerë 315,509 lekë.

- në zbatimin e kontratës “Blerje aparate dhe pajisje për kontrollin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve primare te nënstacioneve”, ka rezultuar se pajisjet janë dorëzuar me vonesë.

Bazuar në Nenin 10, Pika 10.1, të kontratës “Likuidimi i dëmeve për dorëzim të vonuar”, kontraktori duhet të penalizohet me vlerë 1,110,172 lekë.

- gjatë zbatimit të kontratës “Blerje dhe implementimi i një platforme elektronike për realizimin e një sistemi të integruar të administrimit të burimeve financiare, njerëzore dhe logjistike të OST sh.a.” rezulton se, furnizimi i disa pajisjeve dhe shërbimeve është bërë përtej afatit të përcaktuar në kontratë. Për këtë arsye Kontraktori duhet të penalizohet me vlerë 3,412,300 lekë

- dokumentacioni i zbatimit të kontratës “Rikonstruksion i linjës 110 kv Tirana 1-Kashar”, ka rezultuar se Kontraktori “█████” sh.p.k. ka dështuar në përfundimin e kontratës në periudhën e përcaktuar në dokumentet e tenderit me afat 8 ditë (punimet duhet të përfundonin me datë 01.10.2013, në fakt deklarohen të përfunduara me datë 09.10.2013).

Kontraktori ka dështuar në realizimin e punimeve në afatin 8 ditor, si dhe realizimin e tyre sipas projektit, duke mos përmbushur detyrimet sipas Nenin 13, Pika 12.1, të Kontratës.

Bazuar në Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” Neni 7, Par. 3, si dhe në nenin 18 të kushteve të përgjithshme të kontratës, mbikëqyrësi i punimeve dhe menaxherja e kontratës, duhet të propozonin ndalimin e garancisë së punimeve në masën 5 %, me vlerë 1,101,545 lekë.

2. Znj. █████ sepse:

- në zbatimin e kontratës së punimeve civile “Ndërtim sheshe depozitimi me bazamente betoni dhe te mbuluar ne N/Stacionet Elbasan 1, Fier dhe Koms (Burrel)” është autorizuar përdorimin e fondit rezervë pas përfundimit të kontratës, në kundërshtim me Udhëzimin e KM Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Pika 19. Po ashtu, pas përfundimit të punimeve të kontratës janë likuiduar 60 orë pune me makineri, duke shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 69,120 lekë.

-dosja teknike e zbatimit të kontratës nuk është kompletuar me dokumentacionin që ka të bëjë me librin e kantierit, ditarin e punimeve, fotografi gjatë realizimit të punimeve, si dhe procesverbalet e punimeve të maskuara, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” ,Pika 9.

3. Z. █████ në cilësinë e Shefi të NJMT, sepse:

-ka miratuar shtyrjen e afatit të dorëzimit pa shkaqe të përligjura, në kundërshtim me nenin 13, Pika 2, të kushteve të përgjithshme të kontratës, në zbatimin e kontratës “Blerje automjet 7 ton” realizuar nga Njësia OST Tiranë nr. 1”. Bazuar në Nenin 10, të Kontratës “Likuidim për dorëzim të vonuar”, kontraktori duhet të penalizohet për vonesë në dorëzim me afat 18 ditor me vlerë 1,353,600 lekë.

4. Z. █████ në cilësinë e Drejtorit të Investimeve dhe Mjedisit, sepse:

- në tenderin e zhvilluar me objekt “Shtrim me çakëll i impianteve te N/Stacionit 220 kv Tirana1 dhe N/Stacionit 220 kv Elbasan.1”, janë përfshirë punime të cilat kanë qenë realizuara para periudhës së prokurimit, nga ku ka rezultuar se:

Rakordimi ndërmjet drejtorive të OST, është i pamjaftueshëm për të përgatitur procedurat e prokurimit në përputhje me aktet ligjore.

Hartimi i projekt-preventivave nga specialistët e OST, nuk monitorohet siç duhet.

Ndërhyrja për investime në territorin e nënstacionit Elbasan (shtrimi me çakëll), mund të kërkohej të realizohej në kuadër të rehabilitimit të tij, nëpërmjet kontratave të përfituara nga projekti me investime të huaj, masat për të cilat duhet të merreshin nga z. Ylli Demiraj.

- ka kualifikuar operatorë ekonomikë edhe pse nuk kanë përmbushur përcaktimet e dokumenteve të tenderit, kryesisht paraqitjen e stafit teknik dhe kontrata e lidhura me to. Oferta e një operatori ekonomik është pranuar pavarësisht se kontrata e nënshkruar me inxhinierin elektrik i përket një periudhe të ndryshme me atë të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

- në zbatimin e investimit për rikonstruksionin e linjës 35 kv N/Stacioni Sharrë - Shtylla Degëzuese e L30-30/2-1". Megjithëse janë marrë miratimet përkatëse, është realizuar një investim me vlerë 6,099, mijë lekë në një linjë e cila është në administrim të CEZ-Shpërndarje.

Bazuar në dokumentacionin në dispozicion rezulton se, nuk janë marrë masat për kërkimin e alokimit të fondeve për investimin e realizuar në vlerën 6,099 mijë lekë pa t.v.sh.

5. Z. ■ me detyrë Shef i Zyrës së Shërbimeve të Brendshme, sepse:

- ka lejuar në dispozicion të administratorit, gjatë periudhës 20/10/2013- 31.12.2013, 2 makina, në kundërshtim me urdhrin nr. 590, datë 18.02.2011, duke sjellë efekt negativ për shoqërinë në vlerën **352,694 lekë**.

6. Znj. ■ me detyrë Përgjegjëse e Financës NJOT, sepse:

- ka kryer pagesa të padrejta për kuotën ushqimore të përfutur nga punonjësit e Njesisë Operative Tiranë, në kundërshtim me kontratën kolektive të punës, gjatë ditëve me shërbim brenda vendit dhe për ditët e lejes vjetore në vlerën **571,500 lekë**, në kundërshtim me nenin 63 të kontratave kolektive të punës nr. 988/2, datë 01.06.2010 dhe nr. 2298/7, datë 20.06.2013.

7. Znj. ■ me detyrë Përgjegjëse e Financës NJOF, sepse

- ka kryer pagesa të padrejta për kuotën ushqimore të përfutur nga punonjësit nga e Njesisë Operative Fier, në kundërshtim me kontratën kolektive të punës, gjatë ditëve me shërbim brenda vendit dhe për ditët e lejes vjetore në vlerën **954,000 lekë** në kundërshtim me nenin 63 të kontratave kolektive të punës nr. 988/2, datë 01.06.2010 dhe nr. 2298/7, datë 20.06.2013.

8. Znj. ■ me detyrë Përgjegjëse e Financës NJOK

- ka kryer pagesa të padrejta për kuotën ushqimore të përfutur nga punonjësit e Njesisë Operative Korçë, në kundërshtim me kontratën kolektive të punës, gjatë ditëve me shërbim brenda vendit dhe për ditët e lejes vjetore në vlerën **392,750 lekë** në kundërshtim me nenin 63 të kontratave kolektive të punës nr. 988/2, datë 01.06.2010 dhe nr. 2298/7, datë 20.06.2013.

9. Znj. ■

10. Z. ■

11. Znj. ■ me detyrë Përgjegjëse e Financës NJMT

- ka kryer pagesa të padrejta për kuotën ushqimore të përfutur nga punonjësit e NJMT, në kundërshtim me kontratën kolektive të punës, gjatë ditëve me shërbim brenda vendit dhe për ditët e lejes vjetore në vlerën **863,500 lekë** në kundërshtim me nenin 63 të kontratave kolektive të punës nr. 988/2, datë 01.06.2010 dhe nr. 2298/7, datë 20.06.2013.

12. Znj. ■ me detyrë Përgjegjëse e Financës NJOSH.

- ka kryer pagesa të padrejta për kuotën ushqimore të përfutur nga punonjësit e NJOSH, në vlerën **1,292,000 lekë** në kundërshtim me nenin 63 të kontratave kolektive të punës nr. 988/2, datë 01.06.2010 dhe nr. 2298/7, datë 20.06.2013.

13. Znj. ■ në cilësinë e ish - shifes së financës në NJOE, sepse:

- ka kryer pagesa të padrejta për kuotën ushqimore të përfituar nga punonjësit e NJO Elbasan, në vlerën **227,000 lekë** gjatë ditëve të lejes vjetore në kundërshtim me nenin 63 të kontratave kolektive të punës nr. 988/2, datë 01.06.2010 dhe nr. 2298/7, datë 20.06.2013.

- ka lejuar në 11 raste tejkalimin e limitit kohor vjetor me 591 orë, për të cilat punonjësit kanë përfituar një pagesë të padrejtë në kundërshtim me nenin 31 të kontratës kolektive. Pagesa e përfituar padrejtësisht nga punonjësit është në shumën **185,155 lekë**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.

-nuk ka marrë masat e nevojshme ligjore për krijimin e kushteve të inventarizimit vënien në dispozicion të dokumentacionit kontabël, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 20.07.2011 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, “Inventarizimi i aktiveve”.

- nuk ka përcaktuar rregullat si dhe nuk ka nxjerrë urdhrat përkatës për dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të magazinës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 5 “përgjegjësia e titullarit të njësisë publike”.

14. Znj. [REDAKTUAR] me detyrë magazinierë në NJOE, sepse:

- nuk ka marrë në dorëzim detyrën me procesverbal, dhe me dokumentacionin e nevojshëm ligjor e financiar, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 10, 12,13,14 “Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publik”.

- ka mbajtur dokumentacionin e magazinës, vetëm në sasi pa çmim dhe vlerë.

15. Z. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-shefit të NJOE, sepse:

- ka nxjerrë urdhrin mbi përbërjen e anëtarëve të komisionit të inventarizimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” “Përgjegjësitë për inventarizimin” pika 82.

- nuk ka krijuar kushtet për kryerjen e inventarizimit të aseteve të njësisë, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 20.07.2011 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, “Inventarizimi i aktiveve”.

16. Znj. [REDAKTUAR]

17. Z. [REDAKTUAR]

18. Z. [REDAKTUAR]

19. Z. [REDAKTUAR]

20. Z. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarëve të komisionit të inventarizimit, sepse:

- nuk kanë përfunduar brenda afatit të kërkuar deri në datën 31.12.2013, duke mos zbatuar urdhrin e titullarit nr. 119, datë 29.10.2013 “Mbi inventarizimin e aseteve”, ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat Financiare”, i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 20.07.2011, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, “Inventarizimi i aktiveve”.

21. Z. [REDAKTUAR] me detyrë drejtor i NJOE

22. Z. [REDAKTUAR] me detyrë përgjegjës i degës së financës, sepse:

- me veprimet dhe mosveprimet e tyre, për kryerjen e inventarizimit kanë shkaktuar vonesa në përfundimin e inventarëve, dorëzimin në kohë pasqyrave financiare të NJOE dhe mos përfundimin në afat të bilancit të konsoliduar të shoqërisë.

- nuk kanë vepruar menjëherë për miradministrimin e asetëve në njësitë publike, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- nuk kanë krijuar kushtet për inventarizimin e asetëve, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Tabelat Financiare”, i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 20.07.2011 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, “Inventarizimi i aktiveve”.

III. “Vërejtje”, për:

1. Z. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjës i Repartit Mekanik, sepse:

- ka hartuar me mangësi të theksuara dokumentacionin i cili pasqyron kilometrat e përshkruara për automjete, i cili është plotësuar në disa raste pa përcaktuar destinacionin, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 30, të Ministrisë së Financave, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Artan Topiana, Mimoiza Bedini, Eneida Mata, Nefail Xhepexhiu, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhafer Xhorxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT